



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
REGJISTRIN ELEKTRONIK TË DËMEVE TË BYROSË SHQIPTARE TË
SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 105, datë 30.06.2021

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin elektronik të të dhënave të dëmeve sipas parashikimeve të neneve 41 dhe 43 të Ligjit nr. 32/2021, në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 35, pika 11, të Ligjit nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” si dhe të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i rregullores është të sigurojë një funksionim sa më efektiv, të drejtë dhe të bazuar në ligj, të regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë, si dhe të përcaktojë procedurat e raportimit të të dhënave nga Byroja dhe shoqëritë e sigurimit.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a. “Autoritet” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- b. “Byroja” është Byroja Shqiptare e Sigurimit;
- c. “Shoqëri sigurimi” është shoqëria e sigurimit, e cila është e licencuar për të ushtruar veprimtari në sigurimin e detyrueshëm motorik;
- d. “Regjistri elektronik i dëmeve i Byrosë” është sistemi informatik, i cili realizon regjistrimin elektronik (ose online) të dosjeve të dëmeve për rastet e dëmeve të shkaktuara nga mjetet e pasiguruara/paidentifikuara, sipas neneve 41 dhe 43, të Ligjit nr. 32/2021;
- e. Përdorues i brendshëm është:
 - i. Specialisti/punonjësi i Byrosë Shqiptare të Sigurimit, i cili realizon regjistrimin elektronik të dëmeve sipas neneve 41 dhe 59 të Ligjit nr.32/2021;
 - ii. Specialisti/punonjësi i shoqërisë së sigurimit, i cili realizon regjistrimin elektronik të dëmeve sipas nenit 43 të Ligjit nr.32/2021.
- f. Përdorues i jashtëm: është punonjësi/specialisti i Autoritetit;
- g. Kartela shoqëruese e praktikës: është përmbajtja e të dhënave në mënyrë elektronike për secilën dosje të regjistruar në sistem me fushat përkatëse për secilin status.

Neni 5
Detyrimi për të dhënë informacion

1. Byroja dhe shoqëritë e sigurimit, janë përgjegjëse për dhënien e të gjithë informacionit pranë regjistrimit elektronik të dëmeve të Byrosë, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
2. Byroja dhe shoqëritë e sigurimit, raportojnë në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë, të dhënat për çdo praktikë dëmi të hapur prej tyre.
3. Për çdo veprim apo ndryshim të informacioneve të praktikës së dëmit, Byroja dhe shoqëria e sigurimit, raportojnë pranë regjistrimit elektronik të dëmeve të Byrosë, jo më vonë se 1 ditë kalendarike nga marrja e informacionit të ri.
4. Në rast të gabimeve gjatë raportimeve të bëra pranë regjistrimit elektronik të dëmeve të Byrosë, Byroja dhe shoqëria e sigurimit, duhet t’i korrigjojnë menjëherë ato dhe të bëjnë raportimin e saktë në kohë reale.

5. Byroja dhe shoqëria e sigurimit, caktojnë përdoruesin/specialistin të cilët janë përgjegjës për raportimin e të dhënave për dëmet pranë regjistrit elektronik të dëmeve të Byrosë.
6. Dosja e një dëmi është e vetme pavarësisht nga historiku i saj. Në veçanti dosja, e cila bëhet pjesë e një procesi gjyqësor do të jetë vazhdim i shqyrtimit të dosjes ekzistuese të dëmit dhe jo të hapet një ngjarje/dosje e re.

Neni 6

Aksesi i informacionit

1. Niveli i informacionit si dhe aksesit për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm, për të raportuar ose përdorur të dhënat në ndërfaqen e regjistrit elektronik të dëmeve të Byrosë përcaktohen nga Byroja.
2. Përdoruesit e sistemit të regjistrit elektronik të dëmeve të Byrosë kanë të drejta përdorimi si më poshtë:
 - a. Përdorues i brendshëm i Byrosë ka të drejta editimi të dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 41 dhe 59 të Ligjit nr. 32/2021;
 - b. Përdorues i brendshëm i shoqërisë së sigurimit ka të drejta editimi të dëmeve për rastet e përcaktuara në nenin 43 të Ligjit nr. 32/2021;
 - c. Përdoruesi i jashtëm ka vetëm të drejta leximi të informacionit, pa mundësi ndryshimi.

Neni 7

Përgjegjësitë për mirëmbajtjen e regjistrit të dëmeve

1. Byroja është përgjegjëse për funksionimin e plotë të regjistrit elektronik të dëmeve në cilësinë e administratorit të regjistrit.
2. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja janë përgjegjëse për komunikimin e nevojshëm midis pjesëve përbërëse të regjistrit të dëmeve.
3. Ruajtja fizike dhe elektronike e të dhënave të regjistrit elektronik të dëmeve kryhet nga personeli i autorizuar i Byrosë.
4. Mbështetja operationale e programeve kryhet nga personeli i autorizuar nga Byroja, i mbështetur nga specialistë të jashtëm, sipas kontratës të mirëmbajtjes.
5. Regjistri elektronik i dëmeve të Byrosë vepron pa ndërprerje gjatë gjithë javës dhe 24 orëve të ditës.

6. Suporti ndaj përdoruesve të regjistrit të dëmeve jepet përgjatë orarit zyrtar nga administratori i regjistrit nëpërmjet postës elektronike.

Neni 8

Raportimi në regjistrin elektronik

1. Shoqëria e sigurimit dhe Byroja, duhet të marrin të gjitha masat për të përshtatur sistemet informatike respektive të raportimit të dëmeve, për të operuar në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
2. Një praktikë dëmi do të raportohet sipas hierarkisë Ngjarje – Praktikë dëmi për Përfitues, ku:
 - a. Ngjarja - është ndodhia e aksidentit (me të dhënat e sakta të datës dhe vendndodhjes) së bashku me shkaktarin e ngjarjes (nëse identifikohet) me të dhënat e gjeneralitetet e tij, policës dhe mjetit të shkaktarit (nëse identifikohet);
 - b. Praktikë Dëmi për Përfitues - është praktika që hapet për çdo përfitues më vete brenda të njëjtës ngjarje. Praktikant e dëmit kanë të dhënat e vlerave të përlogaritur/rivlerësuar /gjyqësore, statusin e saj, të dhënat gjenerale të përfituesit si dhe pagesat përkatëse.
3. Çdo praktikë dëmi me përfituesit përkatës, identifikohet me një kod unik të gjeneruar nga sistemi i Byrosë.

Neni 9

Plotësimi i të dhënave në regjistrin elektronik

1. Çdo ngjarje duhet të jetë e raportuar vetëm njëherë nga përdoruesit e autorizuar të Byrosë/shoqërive, dhe në rast përfituesi të ri, duhet të hapet një dosje në po këtë ngjarje, e cila identifikohet me një kod unik të ri nga regjistri elektronik i dëmeve të Byrosë.
2. Për çdo lloji dëmi që i përkasin të njëjtit përfitues, në varësi të dokumentacionit dhe afateve të trajtimit, hapet dosje e veçantë brenda të njëjtës ngjarje si më poshtë:
 - i. dëm ndaj pronës (material);
 - ii. dëm ndaj personit.
3. Në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë duhet të raportohet, nëse identifikohet, shkaktari real i ngjarjes dhe jo domosdoshmërisht pronari apo përdoruesi i mjetit në policë. Për rastet e shkaktarëve ku mjeti është në pronësi të një subjekti, tek të dhënat e shkaktarit duhet të vendoset subjekti pronar edhe përdoruesi i mjetit në momentin e aksidentit.

4. Kur kemi të bëjmë me një mjet të pasiguruar, të dhënat për policën e sigurimit do jenë të paplotësuara. Ndërsa në lidhje me të dhënat e mjetit do të plotësohen nga përdoruesit e regjistrit me informacionet që ata kanë.
5. Kur kemi të bëjmë me një mjet të pidentifikuar, të dhënat për shkaktarin dhe policën e sigurimit të automjetit shkaktar të dëmit plotësohen me emërtimin “I Pidentifikuar”.
6. Çdo praktikë dëmi e regjistruar në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë për dëmet e regjistruara dhe me mungesë dokumentacioni, pavarësisht statusit të praktikës duhet të ketë një vlerë nga Byroja/shoqëria e sigurimit (vlera e dëmit e përlogaritur).
7. Në momentin që një dosje dëmi paguhet plotësisht dhe vlera e mbetur bëhet zero, atëherë dosja kalon automatikisht në statusin paguar. Me përfundimin e regresit dosja kalon në status mbyllur.
8. Në plotësimin e dosjes për çdo përfitues duhet të evidentohet vetë personi i dëmtuar/përfituesi dhe jo përfaqësuesit e tij.

Neni 10

Raportet e gjeneruara nga sistemi

1. Plotësimi i të dhënave, bëhet sipas manualit për përdoruesit e regjistrit elektronik të dëmeve të Byrosë.
2. Regjistri elektronik i dëmeve të Byrosë gjeneron raporte në kohë reale.
3. Raportet gjenerohen në formë sintetike dhe analitike nga të gjithë përdoruesit e sistemit.

Neni 11

Mënyra e raportimit të praktikës së dëmit nga Byroja/shoqëria e sigurimit

1. Hapja e praktikës së dëmit bëhet nga Byroja, për rastet e parashikuara në nenet 41 dhe 59, të Ligjit nr. 32/2021 dhe nga shoqëria e sigurimit, për rastet e parashikuara në nenin 43, të Ligjit nr.32/2021, me paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim. Kjo kërkesë raportohet në regjistrin elektronik jo më vonë se 1(një) ditë kalendarike nga paraqitja e saj. Praktika mban numrin unik të gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik i dëmeve të Byrosë.
2. Për rastet e dëmeve të depozituara në Byro, pasi bëhet regjistrimi i praktikës duke plotësuar skedën me të dhënat përkatëse, bëhet dhe ngarkimi i dokumentacionit.

3. Në rastet kur shkaktari i një dëmi, apo shoqëria e sigurimit përgjegjëse identifikohet më vonë, pasi është trajtuar fillimisht prej Byrosë ose shoqërisë së sigurimit si ent kompensues, Byroja/shoqëria kalon praktikën te shoqëria përgjegjëse dhe pasqyrohet në regjistrin elektronik statusi i përditësuar.
4. Byroja për dëmet objekt Fond Kompensimit, të cilat mund t'i delegojë për trajtim dhe pagesë pranë shoqërive të sigurimit, është përgjegjëse për raportimin në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë.
5. Për praktikën Fond Kompensimit për të cilat është përgjegjëse Byroja dhe si procedurë miratohen nga ajo, përdoruesi i brendshëm i saj, kryen ndryshimet përkatëse në regjistër pas shqyrtimit të praktikës si më poshtë:
 - a. përditëson vlerën e miratimit të praktikës;
 - b. përditëson statusin e refuzuar të praktikës.

Neni 12

Veprimet në sistem të praktikave me status gjyqësor dhe përmbarimor

1. Për praktikën në status gjyqësor përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit, bën ndryshimet përkatëse në regjistër jo më vonë se 1(një) ditë kalendarike nga marrja e këtij njoftimi.
2. Përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit i ngarkuar me editimin e të dhënave të proceseve gjyqësore, i përditëson ato jo më vonë se 1(një) ditë kalendarike nga marrja e të dhënave, duke ndjekur procedurat si më poshtë:
 - a. Vendos rezervën e dëmit në çdo fazë;
 - b. Vendos vlerën e dëmshpërblimit sipas vendimit të gjykatës;
 - c. Vendos masën e paaftësisë (kur është e aplikueshme);
 - d. Çdo koment tjetër të nevojshëm për procesin gjyqësor, duke saktësuar shkallën e gjyqësorit në të cilën ndodhet praktika.
3. Përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit ngarkon në regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë dokumentacionin e dorëzuar nga palët gjatë procesit gjyqësor.
4. Përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit bën ndryshimin e statusit të praktikës gjyqësore pas kalimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor dhe shënon zyrën e shërbimit përmbarimor, tarifën e shërbimit përmbarimor dhe përditëson sipas rastit vlerën.

Neni 13

Hedhja e pagesave në sistem dhe ndjekja e procesit të regresit

1. Përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit ngarkon në sistem të gjitha pagesat e kryera nga Byroja/shoqëritë e sigurimit bashkë me dokumentacionin justifikues.
2. PAGESA e hedhur në sistem aktivizon njëkohësisht statusin për padinë e regresit. Ky status plotësohet me Byronë/shoqërinë e sigurimit që ka kryer pagesën, statusin aktual të padisë dhe përgjegjësin që ndjek procedurën e regresit.
3. Përdoruesi i brendshëm i Byrosë/shoqërisë së sigurimit, i cili bën ndjekjen e padisë së regresit si në rrugë gjyqësore ashtu dhe në arkëtimet vullnetare, bën hedhjen e të dhënave në çdo fazë të procesit duke bërë dhe ngarkimin e dokumentacionit përkatës.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021.